


Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Shkurt 2023

Tiranë, më 08 Mars 2023: Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Shkurt 2023, arriti 113,9 kundrejt muajit Dhjetor 2020.

Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Shkurt 2023 është 7,1 %, një vit më parë ky ndryshim ishte 3,9 %. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Shkurt 2023, krahasuar me Janar 2023 është 1,1 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit (%)




Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit.

Rritja vjetore e çmimeve në muajin Shkurt është ndikuar kryesisht nga grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike” me +4,80 pikë përqindje, pasuar nga grupi “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me +0,59 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me +0,50 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “Pije alkoolike dhe duhan” dhe “Hotele, kafene dhe restorante” kanë kontribuar me +0,25 pikë përqindje secili. Çmimet e grupit “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me +0,18 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” me +0,16 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Transporti” me +0,09 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Argëtim dhe kulturë” me +0,08 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Shërbimi arsimor” me +0,07 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “Shëndeti” dhe “Komunikimi” kanë kontribuar me +0,04 pikë përqindje secili.

Për publikim 08/03/2023

Fig. 2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Shkurt 2022, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 13,5 %, pasuar nga grupet “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 6,9 %, “Hotele, kafene dhe restorante” me 5,5 %, “Pije alkoolike dhe duhan” me 5,1 %, “Veshje dhe këpucë” me 4,4 %, “Argëtim dhe kulturë” me 3,4 %, “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 3,2 %, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 3,1 %, “Shërbimi arsimor” me 2,3 %, “Transporti” me 1,7 %, “Komunikimi” me 1,2 % dhe “Shëndeti” me 1,0 %.

Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “qumësht, djathë dhe vezë” u rritën me me 28,0 %, pasuar nga nëngrupet “vajra dhe yndyrna” me 17,4 %, “peshk” me 16,3 %, “bukë dhe drithra” me 15,2 %, “mish” me 13,8 %, “sheqer, recel, mjaltë, çokollata dhe mbëlsira” me 13,2 %, “zarzavate përfshirë patatet” me 9,6 %, etj.

Ndryshimet mujore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Janar 2023, çmimet e grupit “Ushqime dhe pije joalkoolike” u rritën me 3,3 %, pasuar nga grupet “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 0,7 %, “Pije alkoolike dhe duhan”, “Argëtim dhe kulturë” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0,3 % secili, “Hotele, kafene dhe restorante” me 0,2 % dhe “Shëndeti” me 0,1 %. Nga ana tjetër, çmimet i grupit “Transporti” u ulën me 2,8 %, pasuar nga “Veshje dhe këpucë” me 0,2 %.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor 2020=100

| Kodi | Grupet | Peshat | 02-22 | 03-22 | 04-22 | 05-22 | 06-22 | 07-22 | 08-22 | 09-22 | 10-22 | 11-22 | 12-22 | 01-23 | 02-23 |
|------|---|------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| | Gjithsej | 100 | 106,4 | 108,9 | 109,7 | 109,2 | 109,0 | 109,3 | 110,1 | 110,8 | 111,2 | 110,9 | 111,4 | 112,6 | 113,9 |
| 1 | Ushqime dhe pije joalkoolike | 35,6 | 113,4 | 117,8 | 119,1 | 117,2 | 115,6 | 116,2 | 118,0 | 119,3 | 119,8 | 119,7 | 121,4 | 124,5 | 128,7 |
| 2 | Pije alkoolike dhe duhan | 4,9 | 103,3 | 106,3 | 105,8 | 106,3 | 106,3 | 106,8 | 107,4 | 107,7 | 107,3 | 107,4 | 107,7 | 108,2 | 108,6 |
| 3 | Veshje dhe këpucë | 3,6 | 100,9 | 101,5 | 101,4 | 101,6 | 101,7 | 102,3 | 102,0 | 104,2 | 104,7 | 105,2 | 105,6 | 105,5 | 105,3 |
| 4 | Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji | 19,5 | 102,0 | 102,5 | 102,8 | 103,2 | 103,2 | 104,0 | 104,2 | 104,4 | 105,0 | 104,8 | 104,8 | 105,1 | 105,1 |
| 5 | Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë | 7,4 | 101,7 | 102,6 | 103,3 | 103,9 | 104,5 | 105,0 | 105,4 | 106,3 | 107,2 | 107,3 | 107,7 | 108,0 | 108,7 |
| 6 | Shëndeti | 4,2 | 100,9 | 100,9 | 100,8 | 100,8 | 101,0 | 101,3 | 101,3 | 101,6 | 102,0 | 102,1 | 102,0 | 101,9 | 102,0 |
| 7 | Transporti | 6,4 | 111,2 | 121,1 | 123,9 | 124,6 | 130,2 | 125,3 | 125,3 | 123,2 | 125,0 | 119,0 | 115,6 | 116,4 | 113,1 |
| 8 | Komunikimi | 3,1 | 103,3 | 103,3 | 103,6 | 103,6 | 103,4 | 103,7 | 103,9 | 103,9 | 103,8 | 104,4 | 104,6 | 104,6 | 104,6 |
| 9 | Argëtim dhe kulturë | 2,3 | 102,8 | 103,2 | 106,0 | 102,7 | 101,3 | 101,2 | 106,7 | 107,0 | 104,3 | 105,0 | 105,6 | 106,0 | 106,3 |
| 10 | Shërbimi arsimor | 3,0 | 100,6 | 100,8 | 100,8 | 100,8 | 100,8 | 100,9 | 100,9 | 102,6 | 102,2 | 102,5 | 102,8 | 102,9 | 102,9 |
| 11 | Hotele, kafene dhe restorante | 4,5 | 103,9 | 105,2 | 105,7 | 106,2 | 106,6 | 107,2 | 107,6 | 108,0 | 108,1 | 108,7 | 108,7 | 109,4 | 109,5 |
| 12 | Mallra dhe shërbime të ndryshme | 5,5 | 100,3 | 100,7 | 100,9 | 101,0 | 101,2 | 101,6 | 101,8 | 102,7 | 103,0 | 103,1 | 103,0 | 103,3 | 103,6 |

Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

| Kodi | Grupet | 02-22/02-21 | 03-22/03-21 | 04-22/04-21 | 05-22/05-21 | 06-22/06-21 | 07-22/07-21 | 08-22/08-21 | 09-22/09-21 | 10-22/10-21 | 11-22/11-21 | 12-22/12-21 | 01-23/01-22 | 02-23/02-22 |
|------|---|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| | Gjithsej | 3,9 | 5,7 | 6,2 | 6,7 | 7,4 | 7,5 | 8,0 | 8,1 | 8,3 | 7,9 | 7,4 | 7,2 | 7,1 |
| 1 | Ushqime dhe pije joalkoolike | 6,9 | 9,3 | 9,9 | 11,4 | 12,6 | 13,2 | 14,0 | 14,0 | 14,6 | 14,7 | 14,2 | 13,3 | 13,5 |
| 2 | Pije alkoolike dhe duhan | 2,1 | 4,9 | 4,3 | 5,0 | 4,7 | 5,0 | 6,2 | 6,5 | 5,7 | 5,8 | 5,5 | 5,1 | 5,1 |
| 3 | Veshje dhe këpucë | 1,1 | 1,5 | 1,2 | 1,3 | 1,6 | 2,1 | 1,9 | 3,0 | 3,0 | 3,6 | 3,8 | 4,1 | 4,4 |
| 4 | Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji | 1,8 | 2,3 | 2,6 | 2,7 | 2,8 | 3,4 | 3,2 | 3,3 | 3,6 | 3,1 | 2,8 | 3,0 | 3,1 |
| 5 | Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë | 0,8 | 1,4 | 2,7 | 3,2 | 3,8 | 4,2 | 4,7 | 5,5 | 6,5 | 6,2 | 6,5 | 6,4 | 6,9 |
| 6 | Shëndeti | -0,1 | 0,0 | 0,6 | 0,2 | 0,3 | 0,5 | 0,6 | 0,9 | 1,3 | 1,3 | 1,1 | 1,0 | 1,0 |
| 7 | Transporti | 10,4 | 19,9 | 22,5 | 21,7 | 26,9 | 19,7 | 19,3 | 17,2 | 16,9 | 9,6 | 6,0 | 6,5 | 1,7 |
| 8 | Komunikimi | 3,3 | 1,9 | 0,8 | 0,8 | 0,6 | 0,7 | 0,9 | 0,9 | 0,7 | 1,1 | 1,3 | 1,3 | 1,2 |
| 9 | Argëtim dhe kulturë | 2,7 | 3,5 | 4,1 | 1,2 | -0,9 | 0,2 | 5,2 | 4,7 | 1,7 | 1,0 | 1,3 | 1,8 | 3,4 |
| 10 | Shërbimi arsimor | 0,5 | 0,7 | 0,6 | 0,6 | 0,6 | 0,7 | 0,7 | 1,8 | 1,8 | 1,9 | 2,3 | 2,3 | 2,3 |
| 11 | Hotele, kafene dhe restorante | 3,2 | 4,5 | 4,9 | 5,3 | 5,6 | 6,0 | 6,2 | 6,4 | 6,1 | 6,1 | 5,2 | 5,6 | 5,5 |
| 12 | Mallra dhe shërbime të ndryshme | 0,4 | 0,9 | 1,0 | 0,9 | 1,0 | 1,5 | 1,9 | 2,9 | 3,3 | 3,6 | 3,3 | 3,6 | 3,2 |

Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

| Kodi | Grupet | 02-22 | 03-22 | 04-22 | 05-22 | 06-22 | 07-22 | 08-22 | 09-22 | 10-22 | 11-22 | 12-22 | 01-23 | 02-23 |
|------|---|------------|------------|------------|-------------|-------------|------------|------------|------------|------------|-------------|------------|------------|------------|
| | Gjithsej | 1,3 | 2,4 | 0,7 | -0,5 | -0,1 | 0,2 | 0,8 | 0,6 | 0,4 | -0,3 | 0,4 | 1,1 | 1,1 |
| 1 | Ushqime dhe pije joalkoolike | 3,2 | 3,9 | 1,1 | -1,6 | -1,4 | 0,6 | 1,5 | 1,1 | 0,4 | -0,1 | 1,5 | 2,6 | 3,3 |
| 2 | Pije alkoolike dhe duhan | 0,4 | 2,8 | -0,5 | 0,5 | 0,0 | 0,4 | 0,6 | 0,3 | -0,4 | 0,1 | 0,2 | 0,5 | 0,3 |
| 3 | Veshje dhe këpucë | -0,5 | 0,7 | -0,1 | 0,1 | 0,2 | 0,5 | -0,2 | 2,1 | 0,5 | 0,5 | 0,3 | -0,1 | -0,2 |
| 4 | Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji | -0,1 | 0,6 | 0,3 | 0,4 | 0,1 | 0,7 | 0,2 | 0,2 | 0,6 | -0,2 | -0,1 | 0,3 | 0,0 |
| 5 | Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë | 0,2 | 0,8 | 0,8 | 0,5 | 0,6 | 0,4 | 0,4 | 0,9 | 0,8 | 0,2 | 0,3 | 0,3 | 0,7 |
| 6 | Shëndeti | 0,1 | -0,1 | 0,0 | 0,0 | 0,2 | 0,3 | 0,0 | 0,3 | 0,4 | 0,1 | -0,1 | -0,1 | 0,1 |
| 7 | Transporti | 1,8 | 8,9 | 2,3 | 0,5 | 4,5 | -3,7 | 0,0 | -1,7 | 1,5 | -4,8 | -2,8 | 0,7 | -2,8 |
| 8 | Komunikimi | 0,1 | 0,0 | 0,3 | 0,0 | -0,2 | 0,2 | 0,2 | 0,0 | 0,0 | 0,5 | 0,2 | 0,0 | 0,0 |
| 9 | Argëtim dhe kulturë | -1,4 | 0,4 | 2,7 | -3,1 | -1,3 | -0,1 | 5,5 | 0,3 | -2,5 | 0,7 | 0,5 | 0,4 | 0,3 |
| 10 | Shërbimi arsimor | 0,1 | 0,2 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,1 | 0,0 | 1,6 | -0,4 | 0,3 | 0,4 | 0,0 | 0,0 |
| 11 | Hotele, kafene dhe restorante | 0,3 | 1,3 | 0,5 | 0,5 | 0,5 | 0,5 | 0,4 | 0,4 | 0,1 | 0,5 | 0,0 | 0,6 | 0,2 |
| 12 | Mallra dhe shërbime të ndryshme | 0,6 | 0,4 | 0,2 | 0,0 | 0,2 | 0,4 | 0,3 | 0,9 | 0,2 | 0,1 | -0,1 | 0,2 | 0,3 |

Metodologjia

Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2021.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Shporta përbëhet nga 331 produkte dhe shërbime.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mbliidhen çmimet.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit duke filluar nga muaji Janar 2021 llogaritet me bazën e re. Muaji Dhjetor 2020 shërben si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (Dhjetor 2020 = 100).

Përkufizime

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri, Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm, Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.